



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 203 Prot.

Tiranë më 26/09 /2017

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Në datën 25.09.2017 në orën 17:30, në ambientet e AMSHC u mbajt mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së. Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

- 1 - Diskutim për ndryshimet ligjore për KKSHC dhe AMSHC
- 2 - Diskutim për Thirrjen e re
- 3- Etj.

Në prani edhe të Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së, morën pjesë z. Erion Banushi – Përgjegjës i “Sektorit të Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit” si edhe anëtarë të Bordit si më poshtë :

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Alban DUDUSHI
3. Z. Ismail ADEMI
4. Znj. Kozara KATI
5. Znj. Majlinda DHUKA

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur mbledhjen në orën 17:30 duke i dhënë fjalën Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC.

Pasi përshëndet të pranishmit Drejtori bën prezantimin e një nisme të re të AMSHC që lidhet me hartimin dhe përgatitjen e një pyetësoi për Organizatat e Shoqërisë Civile nëpërmjet të cilit AMSHC-ja synon të masë indikatorët standart për çdo vit.

Z.Thano pyet se si do të realizohet plotësimi i formularit dhe z. Erion Banushi shpjegon se plotësimi do të bëhet nëpërmjet e-mail por njëkohësisht ky formular tip do të jetë online në faqen zyrtare të AMSHC në mënyrë që të aksesohet nga të gjitha OJF- të . Ai shpjegon përmbajtjen e pyetësorit duke theksuar rëndësinë bazuar në faktin që nëpërmjet tij mund të nxjerrim një pasqyrë më të saktë se cilat janë organizatat që veprojnë si edhe fushat e veprimtarisë së tyre.

Znj. Dhuka e përshëndet këtë nismë por nisur dhe nga përmbajtja e pyetësorit ajo sugjeron që fillimisht i duhet çuar një kërkesë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mënyrë që të merret miratimi dhe lejimi nga ana e tij sepse për disa të dhëna të pyetësorit duhet ruajtur privatësia. Përveç kësaj duke konstatuar se disa prej pyetjeve kanë karakterin e opinionit ajo rekomandon që pyetësori të organizohet në dy pjesë ku njëra të jetë mbledhëse faktesh dhe pjesa tjetër opsionale në mënyrë që të realizohet ruajtja e privatësisë si edhe të sigurohemi që nuk po paralelizojmë një nismë ekzistente.

Z. Thano gjithashtu thekson që kjo është një nismë dhe ide shumë e mirë, por vetëm duhet të kihet parasysh dhe të gjendet një metodë sa më efektive për mbledhjen e tyre.

Më pas ai i jep fjalën Z. Kananaj për të vazhduar me pikat e tjera të rendit të ditës.

Z. Kananaj shpjegon se një çështje tjetër ka të bëjë me ndryshimet ligjore për AMSHC dhe KKSHC pasi me ndryshimet në përbërjen e qeverisë duhet të ndryshohen edhe disa nga anëtarët si dhe kryetari i këtij Këshilli.

Pasi diskutohet shihet e nevojshme të bëhet një tip propozim apo relacioni dhe në vazhdim të jepet një zgjidhje për mbushjen e këtij vakumi.

Më pas kalohet në diskutim për pikën e fundit të rendit të ditës që lidhet me Thirrjen e Re për Propozime. Drejtori i AMSHC sugjeron që të bëhet një mbledhje tjetër në të cilën pas përfundimit edhe të fazës së konsultave të caktohen prioritetet.

Znj. Dhuka propozon që thirrja të bëhet formale në dhjetor meqënëse në atë periudhë bëhet publik edhe buxheti për vitin vijues.

Si përfundim Z. Thano shpreh se nga dita e nesërme duhet të hapen konsultat, fazë e cila do zgjasë deri në fund të muajit nëntor dhe gjatë kësaj periudhe të jenë marrë të gjitha sugjerimet në lidhje me prioritetet që duhen futur në Thirrjen e re. Sugjerohet që mbledhja e radhës të zhvillohet nga mesi i muajit dhjetor.

Në përfundim të mbledhjes anëtarët ranë dakord unanimisht me çka u diskutua më sipër.

Mbledhja u deklarua e mbyllur në orën 18:30.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adrian THANO

Kryetar i Bordit Mbikqyrës

Majlinda DHUKA

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës

Alban DUDUSHI

Anëtar

Albëna Kociu

Anëtare

Aldo MERKOCI

Anëtar

Endri FUGA

Anëtar

Gelardina PRODANI

Anëtare

Ismail ADEMI

Anëtar

Kozara KATI

Anëtare